

## NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS - kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Emine Mustafa, kryetare, Rasim Rasimi dhe Nesrin Lushta anëtarë, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtorit profesional Bujar Balaj, procesmbajtës, në çështjen penale kundër të dënuarve A.H., për shkak të veprës penale keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar, nga neni 422 par.1 lidhur me par.2 nënpar.2.4 të KPRK-së, V.B., për shkak të veprës penale keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar, nga neni 422 par.1 lidhur me par.2 nënpar.2.4 të KPRK-së, A.M., për shkak të veprës penale mashtrimi në detyrë, nga neni 341 par.3 lidhur me par.1 të KPK-së, dhe i dënuari N.F., për shkak të veprës penale mashtrimi në detyrë, nga neni 341 par.3 lidhur me par.1 të KPK-së, duke vendosur përkitazi me kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë të mbrojtësve të të dënuarve N.F. dhe A.M. të paraqitura kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë, P.nr.362/2016, të datës 15.12.2016 dhe aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës PAKR.nr.57/2017 datë 11.04.2017, në seancën e kolegjit të mbajtur më 11.06.2018, mori këtë:

## A K T G J Y K I M

Me miratimin e kërkesës për mbrojtjen e ligjshmërisë të mbrojtësve të të dënuarve N.F. dhe A.M., anulohen pjesërisht aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë P.nr.362/2016 datë 15.12.2016 (pikën III dhe IV të dispozitivit) dhe aktgjykimi i Gjykatës së Apelit të Kosovës, PAKR.nr.57/2017 datë 11.04.2017 (në pikën I të dispozitivit) dhe çështja në këtë pjesë i kthehet gjykatës së shkallës së parë për rigjykim.

## A r s y e t i m

Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë P.nr.362/2016 datë 15.12.2016 të dënuarit, A.H. dhe V.B., janë shpallur fajtor secili veç e veç për veprën penale keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar, nga neni 422 par.1 lidhur me par.2 nënpar.2.4 të KPRK-së (pika I dhe II të dispozitivit), të dënuarit N.F. dhe A.M., secili veç e veç për veprën penale mashtrimi në detyrë, nga neni 341 par.3 lidhur me par.1 të KPK-së (pika III dhe IV të dispozitivit) dhe të dënuarve A.H., V.B., N.F. dhe A.M. iu kanë shqiptuar dënimet me burgim në kohëzgjatje prej nga 1(një) viti i cili dënim nuk do t'iu ekzekutohet nëse të dënuarit në afatin prej 2 (dy) viteve

nga plotfuqishmëria e këtij aktgjykimi nuk kryejnë vepra tjera penale. Të dënuarit obligohen në mënyrë solidare ti paguajnë shpenzimet e procedurës penale sipas llogarisë përfundimtare të gjykatës, si dhe paushallin gjyqësor secili në shumë prej nga 100 €. Janë obliguar të dënuarit N.F. dhe A.M. që të dëmtuarës MKRS, t'ia kompensojnë dëmin e shkaktuar dhe atë, i dënuari A.M. në shumë prej 100.000 € kurse i dënuari N.F. në shumë prej 188.000 €, në afat jo më gjatë se tre muaj, pasi ky aktgjykimi të merr formën e prerë, nën kërcënim të përmbartimit të detyrueshëm.

Me aktgjykimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës, PAKR.nr.57/2017 të datës 11.04.2017, është aprovuar ankesa e PTH në Prishtinë sa i përket vendimit për dënimin, ashtu që Gjykata e Apelit të dënuarit N.F., për veprën penale për të cilën është shpallur fajtor i shqipton dënimin në kohëzgjatje prej 2 (dy) viteve i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i dënuari në afatin prej 3 (tri) viteve nuk kryen vepër tjetër penale, dhe urdhërohet i dënuari në bazë të nenit 62 par.2 nënpar.2.2 të KPRK, që MKRS t'ia kompensojë dëmin e shkaktuar në shumë prej 188.000 (njëqind e tetëdhjetë e tetë mijë) € në afat prej 3 muajve, pasi që aktgjykimi të merr formën e prerë nën kërcënimin e ekzekutimit të dhunshëm në të kundërtën nëse i dënuari nuk përmbush detyrimin dhe nuk ia kompenzon dëmin e shkaktuar MKRS dënimi me kusht do të revokohet, të dënuarit A.M., për veprën penale për të cilën është shpallur fajtor i shqipton dënimin me burgim në kohëzgjatje prej 1 (viti) e 6 (gjashtë) muaj, e i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i dënuari në afatin e verifikimit prej 3 (tri) viteve nuk kryen vepër tjetër penale, dhe urdhërohet i akuzuari në bazë të nenit 62 par.2 nënpar.2.2 të KPRK, që MKRS t'ia kompensojë dëmin e shkaktuar në shumë prej 100.000 (njëqindmijë) €, në afat prej 3 muajve pasi që aktgjykimi të merr formën e prerë nën kërcënimin e ekzekutimit të dhunshëm, e në të kundërtën, nëse i dënuari nuk e përmbush detyrimin dhe nuk e kompenzon dëmin e shkaktuar MKRS dënimi me kusht do të revokohet. Me aprovimin e ankesës të mbrojtësit të dënuarit V.B., ndryshohet aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë dhe i dënuari V.B., lirohet nga akuza, për veprën penale keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar nga neni 422 par.1 nënpar.2 pika 2.4 të KPRK. Me aprovimin e ankesës së mbrojtësit të dënuarit A.H., ndryshohet aktgjykimi i shkallës së parë ashtu që ndaj të dënuarit A.H., refuzohet akuza për shkak të parashkrimit të ndjekjes penale.

Kundër këtyre aktgjykimëve kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë kanë paraqitur mbrojtësit e të dënuarve: N.F. av. O.H., nga Prishtina, dhe A.M. av. A.K., nga Prishtina, për shkak të shkeljeve esenciale së dispozitave të procedurës penale, për shkak të shkeljeve tjera të dispozitave të procedurës penale dhe për shkak të shkeljeve të ligjit penal me propozim që kërkesat për mbrojtjen e ligjshmërisë të aprovohen si të bazuara, kurse aktgjykimet e kundërshtuara të anulohen dhe çështja ti kthehet gjykatës së shkallës së parë në rigjykim dhe rivendosje.

Përgjigje në kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë ka dhënë Prokurori i Shtetit, me parashtresën KMLP.II.nr.181/2017 e datës 29.09.2017, me të cilën propozon që kërkesat për mbrojtjen e ligjshmërisë e mbrojtësve të të pandehurve të refuzohen si të pabazuara.

Gjykata Supreme e Kosovës në seancën e kolegjit shqyrtoi shkresat e lëndës në kuptim të nenit 435 par.1 lidhur me nenin 436 par.1 të KPPK-së, vlerësoi pretendimet në kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë dhe gjeti se:

Kërkesat e mbrojtësve të të dënuarve janë të bazuara.

Mbrojtësi i të dënuarit N.F., në kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë ndër të tjera pretendon se gjykata e shkallës së parë në rastin konkret e zbaton dispozitën e nenit 3 par.2 të KPK-së të Kodit të Përkohshëm Penal të Kosovës, si ligjin më të favorshëm, kurse Gjykata e Apelit e Kosovës, nuk respekton këtë parim në procedurën e ankimimit ashtu që me rastin e përcaktimit të sanksionit penal e ka aplikuar Kodin Penal të Kosovës i cili është më i disfavorshëm për të dënuarin. Mbrojtësi i të dënuarit N.F., duke u thirrur në dispozitën e nenit 43 të KPK-së thekson se gjykata në këtë çështje penalo-juridike i ka përcaktuar të dënuarit dënim me kusht si dhe e ka obliguar të dënuarin që në afat prej 3 muajsh pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit MKRS t'ia kompensoj shumën prej 188.000,00 euro nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm. Po ashtu sipas dispozitës së nenit 43, 45 të KPK-së, gjykata në të njëjtën kohë ka bërë edhe revokimin e dënimit me kusht, ndërsa kjo dispozitë ligjore ka përcaktuar revokimin e dënimit me kusht në rrethanat e kryerjes së një vepre të re penale, andaj për mbrojtjen kjo mënyrë e përcaktimit e matjes së dënimit është konfuze dhe jo e ligjshme sepse rezulton se kushti për kompensim duhet të përmbushet me çdo kusht në afat prej 3 (tre) muajsh, ndërsa ligji ka përcaktuar se nëse kushti nuk përmbushet kohëzgjatja e afatit për përmbushje mund të zgjatet, ndryshohet kushti apo mund ta revokoj dënimin, por në asnjë rrethanë ta detyroj ta ekzekutoj në mënyrë të dhunshme dhe po ashtu ta revokoj dënimin me kusht. Gjykata e Apelit me aktgjykimin e saj, thuhet në kërkesë, nuk eliminoj shkeljet e pretenduara, porse vendimin e saj e ka marr me shkelje tjera të drejtës materiale të cilat edhe më shumë i kanë rënduar dhe cenuar të drejtat e të dënuarit N. Për më tepër Gjykata e Apelit në gjykimin e kësaj çështje nuk e respektoj parimin bazë të së drejtës penale për aplikimin e ligjit më të favorshëm për të pandehurin, porse me aktgjykimin e saj e aplikoj edhe ligjin e vjetër edhe atë të riun që në drejtësi kjo rrethanë quhet aplikim i një ligji që nuk ekziston. Po ashtu në kërkesë mbrojtësi i të dënuarit N. thekson se gjykata e shkallës së parë duke vendosur në procedurë të rigjykitimit-rivendosjes edhe pse ka qenë e rekomanduar nga Gjykata e Apelit që në procedurën e rivendosjes të bëjë vlerësimin e ekspertizës së ekspertit financiar dhe provave tjera të nxjerr përfundim të drejtë ligjor, e njëjta një gjë të tillë nuk e ndërmori. Gjithashtu, mbrojtësi në kërkesë thekson se i dënuari N.F., në vitin 2006, ka lidhur kontratë për projektin e filmit “Power Cuts” në mes të kompanisë “Concordia Pictur”- N.F. dhe Ministrisë të Ministrisë së Kulturës Rinisë dhe Sportit A.H. dhe se ka pranuar nga MKRS shumën prej 22.000.000,00 €, ndërkaq kompanisë filmike i është transferuar shuma prej 188.000,00 € dhe ka marr obligim për implementimin e projektit filmik brenda 1 viti. Në kërkesë pretendohet se janë paraqitur vonesa në realizimin e projektit për shkak se në vitin 2006, njëri nga producentët kryesor G.S., vdes nga një sulm i papritur, ashtu që për një kohë xhirimi i filmit u ndërpre. Me qëllim të realizimit të filmit, i dënuari N., orientohet në gjetjen e producentëve tjerë, ashtu që në vitin 2009 gjen kompaninë angleze “Left Ye Blind” e cila siguroj mjete për xhirimin e filmit “Në kërkim të Larës”. Për arsye të këtyre vonesave për realizimin e filmit, kompania

“Concordia Picture”, me MKRS-së, në procedurë civile arrijnë një marrëveshje gjyqësore për vazhdimin e afatit të kontratës, me të cilën deri më 01.03.2011 duhet të realizohej projekti filmik ose në të kundërtën të hollat në shumë prej 188.000,00 € t'i kthehen ministrisë përkatëse. Arsyetimi për përmbushjen me sukses të këtij projekti filmik provohet me urdhërpagesat tjera shoqëruese C.nr.11310/2006 në shumë prej 50.000 €, C.nr.11293/2006 në shumë prej 45.000 €, C.nr.11306/2006 në shumë prej 15.000 €, C.nr.11306/2006 në shumë prej 16.00 € si dhe C.nr.11306/2006 në shumë prej 17.000 €, të gjitha të mbyllura dhe të arsyetuara nga personat kompetent. Me 26 qershor 2012 nga Kompania e Distribuimit dhe shfaqjen e filmave “Genci” në Prishtinë nënshkruar nga M.V.- menaxhere dhe producentit N.F., nënshkruajnë aktin e me të cilin vërtetohet shfaqja - premiera e filmit. Sa i përket llogarisë siç thuhet në kërkesë në aspektin ekonomik-financiar, është bërë një ekspertizë e gjithë dokumentacionit në mënyrë analitike dhe profesionale nga eksperti gjyqësor R.B., i cili në përfundimin e tij ka thënë se nuk bëhet fjalë për dëmtim të buxhetit shtetëror të Ministrisë së Kulturës, por se vonesë ka pasur. Mbrojtja konsideron se Gjykata gabimisht ka vepruar në rastin kur i ka kontestuar shpenzimet e arsyetuara të filmit apo çfarëdo shpenzimi tjetër ekonomik-financiar apo të çfarëdo ekspertize nga ana e gjykatës, duke konstatuar se prezantimi përbënë tejkallim të detyrave të saja. Në rast se Gjykata nuk bindet me vlerësimin e ekspertit, si në rastin konkret, e njëjta ka mundur të kërkoj sqarime shtesë apo edhe ekspertizë të re, mirëpo në asnjë rrethanë të merr vet rolin e ekspertit. E krejt në fund, theksohet se meqenëse gjykata e shkallës së parë, në procedurën e rigjyimit nuk ka përfillur rekomandimet e Gjykatës së Apelit që të konstatoj shkeljet esenciale të dispozitave të procedurës penale dhe nxjerrjen e një vendimi të ligjshëm, është propozuar që edhe njëherë çështja të kthehet në rigjykim në gjykatën e shkallës së parë e cila edhe njëherë të nxjerr dhe vlerësoj të gjitha provat veç e veç e sidomos të vlerësoj ekspertizën e ekspertit financiar, dhe më pas të nxjerr përfundimin të drejtë dhe ligjor dhe të shikoj se në veprimet e të dënuarve a manifestohen elementet e veprës penale apo kemi të bëjmë me një raport civilo-juridik apo raport ekonomik-juridik si dhe duke pasur parasysh shkeljet e potencuara në kërkesë.

Edhe mbrojtësi i të dënuarit A.M., në pretendimet e tija përkitazi me vendimet e atakuara thekson se arsyetimi i aktgjyimit të Gjykatës së shkallës së parë dhe ai i gjykatës së shkallës së dytë janë në kundërtënie të plotë me dispozitivin për faktin se në arsyetim nuk përmendin asnjë provë e vetme për ta konstatuar se cila llogari është e rreme, dhe se faturat e paraqitura nga i dënuari A., janë fatura fiktive. Gjykata e Apelit me vendimin e saj fare nuk e trajton pranueshmërinë dhe besueshmërinë e ekspertizës së ekspertit financiar R.B., se askund në ekspertizë nuk përmendët se i dënuari A.M., ka prezantuar llogari të rreme, përkundrazi në ekspertizë thuhet se i njëjti ka arsyetuar më shumë se 94 % të shpenzimeve. Gjithashtu mbrojtja konsideron se aktgjykimi i atakuar përbënë shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale të cilat kanë ndikuar në ligjshmërinë e vendimit gjyqësor nga neni 432 par.1 pika 1.3, për shkak se gjatë procedurës penale, gjykata e shkallës së parë vazhdimisht ka refuzuar pa arsye propozimin e mbrojtjes për caktimin e ekspertit të kinematografisë, duke shkelur në këtë mënyrë të drejtat e mbrojtjes gjë që ka ndikuar në marrjen e aktgjyimit të paligjshëm dhe të padrejtë. Ky ekspert, siç thuhet në kërkesë, do të vlerësonte në mënyrë të saktë se cilat janë fazat e realizimit të projektit filmik, se për cilat faza të realizimit të projektit filmik kanë qenë të destinuara paratë

e pranuar nga Kompania “Morina Films”, si dhe do të përcaktonte se a janë shpenzuar mjetet në përputhje me destinimin për të cilin janë marrë, pra për realizimin e këtij projekti filmik.

Sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme pretendimet e më sipërme për mbrojtje të ligjshmërisë të mbrojtësve të të pandehurve N.F. dhe A.M., janë të bazuara aktgjykimet e kundërshtuara janë marr me shkelje esenciale të dispozitave të KPPK-së nga neni 432 par.1.2 lidhur me nenin 384 par.1 pika 10,12 të KPPK-së lidhur me nenin 370 par.6 dhe 7 të KPPK-së dhe nenit 435.4 të KPPK-së si dhe shkelje dispozitave të Kodit Penal të Kosovës.

Së pari gjykata e Apelit e Kosovës, në procedurën e ankimit duke e aprovuar si të bazuar ankesën e Prokurorit të Prokurorisë Themelore në Prishtinë, e ka ndryshuar aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë duke u shqiptuar dënim më të ashpër të dënuarve N.F. e A.M., për shkak të veprës penale mashtrimi në detyrë, nga neni 341 par.3 të Kodit të Përkohshëm Penal të Kosovës, ndërsa me rastin e përcaktimit e sanksionit penal respektivisht shqiptimin e dënimit plotësues nga dispozita e nenit 62 par.2 nënpar.2.2 të Kodit Penal të Kosovës në fuqi dhe mënyrës së ekzekutimit të tyre në mënyrë të dhunshme, nëse të dënuarit nuk e përmbushin detyrimin ndaj MKSK-së brenda afatit të përcaktuar, dënimi me kusht do t’u revokohet respektivisht t’u zëvendësohet me dënim me burgim efektiv, duke ju referuar nenit 54 dhe 62.3 të KPRK-së, ashtu siç me të drejtë pretendohet nga mbrojtësi i të dënuarit N.F., ky qëndrim bie ndesh me nenin 2 par.2 të KPK-së si ligj më i favorshëm për të dënuarin, ku theksohet se *askujt nuk mund t’i shqiptohet sanksioni penal ose masa e trajtimit të detyrueshëm për një vepër nëse para kryerjes së saj nuk është përcaktuar me ligj si vepër penale dhe nuk është paraparë sanksioni penal ose masa e trajtimit të detyrueshëm për atë vepër*, e që është njëkohësisht në kundërshtim të plotë edhe me dispozitën e nenit 3 par.2 të KPPK-së në të cilin theksohet se *në rast se ligji në fuqi ndryshon para shqiptimit të vendimit të formës së prerë, atëherë ndaj kryesit zbatohet ligji që është më i favorshëm*. Gjykata e Apeli në rastin konkret nuk ka mundur t’i aplikoj në mënyrë të kombinuar dispozitat e ligjit që ka pushuar së funksionuari dhe të ligjit që gjendet në fuqi sepse, po të lejohej mundësia e tillë, atëherë gjykata në fakt krijon ligj të ri penal, gjegjësisht do të gjykonte kryesin e veprës penale sipas ndonjë ligji që nuk ka qenë në fuqi asnjëherë.

Po ashtu, qëndron pretendimi i mbrojtësit të dënuarit N.F., në kërkesë se aktgjykimi i Gjykatës së Apelit është marr me shkelje të Ligjit penal në rastin kur ka urdhëruar të dënuarit se nëse nuk i kompensojnë dëmet e shkaktuara MKRS-së, dhe atë i dënuari N.F., shumën e mjeteve financiare prej 188.000 euro, ndërsa A.M., shumën prej 100.000 euro, në pajtim me dispozitën e nenit 54 dhe 62 të KPRK-së, atëherë gjykata themelore kompetente do të filloj procedura e revokimit me kusht ndaj të dënuarve, sepse këto dispozita ligjore fare nuk i referohen rastit konkret për faktin se nuk bëhet fjalë për kryerje të ndonjë veprë penale të mëparshme para se të jetë dënuar me kusht..., ndërsa në rastin konkret gjen vend dispozita e nenit 47 të KPPK-së ku theksohet se *nëse dënimi me kusht është kushtëzuar me përmbushjen e një detyrimi të paraparë me nenin 43(3) të këtij Kodi dhe personi i dënuar nuk e përmbush këtë detyrim në afatin e caktuar nga gjykata, gjykata mund ta vazhdojë afatin e përmbushjes së detyrimit brenda afatit të*

*verifikimit apo mund ta revokojë dënimin me kusht dhe ta ekzekutojë dënimin i cili është caktuar me dënimin me kusht. Nëse gjykata konstaton se i dënuari për shkaqe të arsyeshme nuk ka mund ta përmbushë detyrimin e caktuar më parë, gjykata e heq përmbushjen e atij detyrimi ose e zëvendëson atë me një detyrim tjetër përkatës të paraparë me ligj.*

Po ashtu, kjo gjykatë vlerëson se aktgjykimet e instancës më të ultë janë marr me shkelje ligjore kur në arsyetimin e aktgjykimeve kanë konstatuar se të dënuarit: N.F., me qëllim të përfitimit të dobisë pasurore në vend të filmit “Power Cuts”, ka paraqitur filmin në kinemanë ABC, “Në Kërkim të Larës” e me qëllim që subvencionin të cilin e kishte marrë nga MKRS, ta arsyetoj dhe në këtë mënyrë është bërë prezantimi i rrem të raportit të llogarive se subvencioni është përdorur për filmin “Pover Cuts”, e po ashtu edhe për të dënuarin A.M., theksohet se ka vepruar në mënyrë të njëjtë si dhe i dënuari N.F., duke paraqitur llogari të rreme i cili e arsyeton shumën sipas ekspertit financiar R.B., në shumë prej 94.128 euro e të cilat holla janë harxhuar për veprime të ndryshme e që nuk kanë qenë të natyrës për realizimin e filmit “Mysafir në Sofër”, ku figurojnë shpenzime të akomodimit nëpër hotele të pagesave për honorar për persona të ndryshëm kinse për realizimin e filmit konstatohet në vendimet e kundërshtuara edhe pse i dënuari e ka ditur se për projektin e filmit prej 5.000.000 euro është projekt i perealizuar, që është projekt i pa realizueshëm e nga kjo del përfundimi se subvencionet të cilat i ka marrë nga MKRS, në bazë të aneks kontratës i ka marrë me qëllim të dobisë pasurore. Janë konstatime dhe vlerësime të gabuara ashtu siç me të drejtë kanë pretenduar edhe mbrojtësit e të dënuarve në kërkesat e tyre. Rrjedhimisht gjykata e instancës së parë, e miratuar edhe nga Gjykata e Apelit, gjatë administrimit të provave pjesërisht u kanë dhënë besimin deklaratave të dënuarve, vlerësimit të ekspertizës financiare të ekspertit për faktin se mjeteve provuese ose duhet t`u jepet besimi i plotë ose jo, gjegjësisht arsyetohet cilës pjesë dhe për çfarë arsyes i jepet besimi. Në vendimet e gjykatave të kundërshtuara ndër të tjera theksohet se të dënuarit me qëllim të përfitimit të kundërligjshëm të dobisë pasurore për vete kanë prezantuar në MRKS llogari të rreme duke mos cituar asnjë provë të vetme gjatë shqyrtimit gjyqësor për ta mbështetur bindjen e saj se faturat e prezantuara nga të dënuarit janë fiktive. Në aktgjykimet e atakuara, për këtë gjykatë është e pakuptueshme se cilës pjesë të ekspertizës së ekspertit financiar gjykata i ka dhënë besimin e cilës jo. Përkitazi me këtë në ekspertizën financiare të ekspertit R.B., gjegjësisht faqe 17 jepet konstatimi për të dënuarin N.F., sa i përket realizimit të filmit ku mes tjerash theksohet “Producenti tani i dënuari N.F., pronar i kompanisë filmike “Concordia Pictures”, për prodhimin e gjatë me titull “Power Cuts” ka pasur të lidhur kontratën me KKRS-ën të nënshkruar nga Ministri i atëhershëm A.H., për subvencionimin e filmit. Kontrata është nënshkruar më datë 27.02.2006, në vlerë prej 220.000 euro apo shprehur në përqindje në shumë prej 30% çmimit total të filmit. Në kontratë janë paraparë obligimet reciproke të palëve kontraktuale. Producenti N.F. edhe pse me vonesë të konsiderueshme, pra duke mos i respektuar në tersi dispozitat e kontratës, ka arritur që më datë 02.07.2012 pas incizimeve dhe xhirimeve në gjashtë shtete të ndryshme të Evropës ta përfundoj me sukses projektin filmik, duke i sjellë MKRS, DVD-në. Vonesën e përfundimit të filmit e ka arsyetuar me vdekjen në ndërkohë të koproducentit dhe tërheqjen e koproducentit tjetër e që mund të konsiderohen si vështirësi objektive në kuptim të respektimit të afatit. Po ashtu, është dhënë mendim dhe konstatim

përfundimtar lidhur me të dënuarin A.M., në faqen 31 po të njëjtës ekspertizë ku ndër të tjera është konstatuar”, ka ekzistuar aneks kontrata e lidhur mes MKRS-së dhe “Morina Films”. Sipas aneks kontratës nga llogaria e MKRS-së në dobi të llogarisë së kompanisë “Morina Films” është transferuar shuma prej 100.000,00 euro si paradhënie për subvencionimin e projektit filmik “Mysafir në Sofër”. Në aneks kontratë janë paraparë detyrimet dhe përgjegjësitë e palëve kontraktuale. Producenti A.M. i ka arsyetuar pjesërisht shpenzimet e fazës së parë në shumë prej 94.128.87 euro, nga rrjedhe se nuk i ka arsyetuar edhe 5.871.13, për çka siç thuhet duhet të mbaj përgjegjësi. Nuk ka respektuar dispozitat e aneks kontratës sa i përket arsyetimit të mjeteve të përfituara nga financimi i filmit, duke mos ofruar dëshmi të mjaftueshme për mos përmbushje, nuk ka kthyer mjetet në shumë prej 100.000.00 euro...”.

Mangësitë dhe kontradiktat e sipërpërmendura paraqesin shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 384 par.1 pika 12 të KPPK-së.

Prandaj, nga arsyet e sipër cekura konkludimet e gjykatës së shkallës së parë dhe asaj të shkallës së dytë nuk mund të pranohen si të drejta dhe të ligjshme, ashtu është dashur që aktgjykimet e kundërshtuara të anulohen dhe çështja t'i kthehet gjykatës së shkallës së parë në rigjykim - neni 438 i KPPK-së.

Në rigjykim gjykata e shkallës së parë dhe ajo e shkallës së dytë duhet të veprojnë sipas vërejtjeve të përmendura dhe pasi që t'i administroj të gjitha provat ( posaçërisht të fokusohen në vlerësimin e ekspertizës ekzistuese duke e ftuar ekspertin në seancën e shqyrtimit gjyqësor për sqarime shtesë, apo sipas nevojës dhe vlerësimit të gjykatës, të caktoj ekspertizë tjetër nga lëmia e kinematografisë), të njëjtat ti vlerësojnë dhe varësisht nga rezultati i vlerësimit të provave duhet të nxjerrën konkluzione të drejta të ligjshme dhe të bazuara në provat e administruara e më pastaj të nxirret vendimi përkatës, duke pasur parasysh edhe pretendimet tjera të cekura në kërkesë.

Nga çka u tha si më lartë e në pajtim me dispozitën e nenit 438 të KPPK-së u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

## GJYKATA SUPREME E KOSOVËS NË PRISHTINË

Pml.nr.259/2018, më datë 11.06.2018

Procesmbajtës,  
Bujar Balaj

Kryetare e kolegjit,  
Emine Mustafa